




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“ALBATEC” SH.P.K.

Numri i biznesit - 70964880

Drejtoreshë – Lavdije KRASNIQI

Radio Drenasi

Rr/Dardania, 272

Fushë Kosovë

Ref: 1907/835/LIC/ni

VENDIM

për ndryshimin e emrit të Radio Drenasi në Radio Capital FM

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Medive (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio Drenasi është Ofrues i Shërbimit Medial Audio (Radio), i cili është i licencuar nga ana e Komisionit të Pavarur të Mediave për transmetimin tokësorë të radio programeve, në gjuhën shqipe, në Regjionin e Prishtinës dhe me mbulueshmëri regjionale.
3. Më datën 5 korrik 2019, Radio Drenasi, ka dorëzuar një kërkesë me shkrim në Zyrën Ekzekutive të KPM-së, me anë të së cilës ka kërkuar miratimin e KPM-së për ndryshimin e emrit në “Radio Capital FM”.

Arsyetimi

4. Neni 21, paragrafi 7 i Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (KPM - 2017/02), përcakton: *“I Licencuari duhet ta identifikojë përmbajtjen e tij me anë të logos, e cila mund të ndryshohet vetëm me miratim paraprak nga KPM-ja”*.
5. Komisioni konstaton se, emri i propozuar për ndryshim “Radio Capital FM”, nuk është i ngjashëm me asnjë nga emrat e të licencuarve të KPM-së dhe se gjatë përdorimit të tij për identifikim nuk do të shkaktoj konfuzion tek dëgjuesit, dhe është i pranueshëm për KPM-në, prandaj, kërkesa për ndryshimin e emrit të Radio Drenasi në “Radio Capital FM” i plotëson kushtet për miratim.

6. Komisioni konsideron se, kërkesa e Radio Drenasit për ndryshimin e emrit në Radio Capital FM është parashtruar në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kushtet për miratim.

Vendim

7. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 24 korrik 2019, merr vendim për miratimin e kërkesës për ndryshimin e emrit të Radio Drenasi në Radio Capital FM.
8. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.



Muja FERATI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



24.07.2019.

datë